



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr 4188 Prot,

Lezhë, më 20 / 03 / 2020

VENDIM

Nr 35, Datë 20/03/2020

“Për përdorimin e fondit të kontigjencës dhe atij rezervë”

Në zbatim të nenin 54 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimi të buxhetit”, ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e përdorimit të fondit rezervë dhe të kontigjencës në shumën 800 000 (tetëqind mijë) lekë, konkretisht:

- Pakësohen fondet në programin dhe në strukturën ekonomike si më poshtë:

-Gr. 00, Program 01100 Kap 01 Art 604 për shumën 300 000 lekë (Fond rezervë)

-Gr. 00, Program 01100 Kap 01 Art 604 për shumën 500 000 lekë (Fond kontigjence)

- Të shtohen fondet në programin dhe në strukturën ekonomike:

-Gr. 00, Program 10430 Kap 01 Art 602 për shumën 800 000 lekë, shumë e cila do të përdoret për blerjen e pakove ushqimore për familjet në nevojë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

